



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr 77, Datë 31.05.2019**

**MBI**

**MIRATIMIN E “MARRËVESHJES PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” NËNSHKRUAR MIDIS “OSHEE” SH.A DHE “ENERGIA GAS AND POWER” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, nenit 20 pika 1 të marrëveshjes së sigurimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike dhe Furnizuesit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 24, datë 15.02.2017, ndryshuar me Vendimin nr.58, datë 15.04.2019, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nënshkruar midis shoqërisë "OSHEE" sh.a dhe shoqërisë "ENERGIA GAS AND POWER" sh.p.k.

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “OSHEE” sh.a me shkresën nr. 10004/2 Prot., datë 07.05.2019, protokolluar me tonën me Nr.333 Prot, datë 09.05.2019, ka dërguar në ERE marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike me nr.10004 Prot, datë 06.05.2019 të nënshkruar midis "OSHEE" sh.a dhe "ENERGIA GAS AND POWER" sh.p.k, me qëllim miratimin nga ERE të kësaj marrëveshje në zbatim të Vendimit të Bordit të ERE-s, Nr. 24, datë 15.02.2017, "*Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE Sh.a dhe furnizuesit të energjisë elektrike*", i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.04.2019.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 28.12.2015, ka licencuar shoqërinë "Le Trading Albania" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar dhe subjekti është mbajtës i licencës nr. 322, seria F15.

- Në vijim me vendimin Nr. 165, datë 19.07.2018, Bordi i ERE ka vendosur, të miratojë kërkesën e shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., për modifikimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nr. 322, seria F15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr.96, datë 27.10.2014 ka licensuar shoqërinë "Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike" sh.a në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike", për një afat 30-vjeçar, i ndryshuar me vendimin nr.216, datë 11.10.2018 dhe me vendimin nr.264, datë 20.12.2018.
- Në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s sa më sipër cituar nr.24, datë 15.02.2017 "*Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe furnizuesit të energjisë elektrike*", i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.04.2019 është parashikuar në nenin 20, pika 1 të saj se, "*Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t'u dërguar për miratim në ERE dhe pikën 20.2 se, Palët deklarojnë se nënshkrimi i kësaj Marrëveshje bëhet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe se ky nënshkrim ka fuqi për shoqëritë të cilët ata përfaqësojnë.*
- Marrëveshja e nënshkruar nga palët është hartuar në përputhje me aktin e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr.24, datë 15.02.2017, "*Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe furnizuesit të energjisë elektrike*", i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.04.2019.
- Vendimi nr.58, datë 15.04.2019, ka vendosur "*Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE sh.a ) dhe Furnizuesit dhe.ka miratuar ndryshime në dispozitat e marreveshjes tip të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr.24, datë 15.02.2017 .*

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE:

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për "*Miratimin e marrëveshjes për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjise Elektrike nr.10004 Prot, datë 06.05.2019 nënshkruar midis shoqërisë "OSHEE" sh.a dhe shoqërisë " ENERGIA GAS AND POWER " sh.p.k*".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**